



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 866/9 Prot.

Tiranë, më 16.09. 2024

V E N D I M

Nr. 243, Datë 16.09. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 127 Regj, datë 07.06.2024, paraqitur nga ankuesi nga z. S.H kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), Universitetit të Mjekësisë Tiranë (UMT) dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, “*gjendje arsimore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga ankuesi S.H, në mes të tjerash ai informon se, është President në detyrë i Sindikatës së Pavarur të Punonjësve të Sistemit Shëndetësor të Shqipërisë dhe anëtar i Komisionit të Zgjeruar EESC të Bashkimit Evropian për vendet aderuese për tu bërë pjesë e BE. Ankuesi parashtron se:

“Unë S.N.H kam aplikuar në vitin 2015 për titullin akademik “Profesor” në Universitetin e Mjekësisë Tiranë. Për arsye diskriminimi, korrupsioni, apo për arsye të zbatimit pa kushte nga drejtuesit e Universitetit të Mjekësisë të vendimeve të marra nga organizatat kriminale-mafioze në Shqipëri, trajtimi i dosjes time ligjërish ka patur afat tre mujor, dosja ime e shqyrtuar me vonesë, ka marrë vlerësim pozitiv nga Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik (Universiteti i Mjekësisë), për titullin akademik “Profesor”, por për tërheqjen e titullit “Profesor” nuk jam thirrur nga Univesriteti i Mjekësisë akoma dhe sot.”

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Kam konkuruar në vitin 2015 për pozicionin e pedagogut të brendshëm në Universitetin e Mjekësisë, e kam fituar konkursin me 270 pikë para fituesit të shpallur, por vendi i punës i fituar prej meje me konkurs u përvetësua. I jam drejtuar rektorit A.Gj dhe Ministrisë së Arsimit, si dhe kam kërkuar ballafaqim me dosjen dhe dosjet, por kërkesa ime nuk u pranua.

Për shkak të persekutimit në Republikën e Shqipërisë, isha i detyruar të migroj, që në vitin 2015 e në vijim të jem lektor universitar në Prishtinë, Kosovë, ku në vitin 2017, Kolegji Universitar ka ngritur komisionin për trajtimin e kërkesës time dhe konkurimin për fitimin e titullit “Profesor”. Senati i Kolegjit të Akredituar dhe i Liçencuar nga Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës më ka akorduar titullin akademik “Profesor”.

Njohja e titullit “Profesor” të fituar prej meje nuk ka patur dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore dhe kushtetuese. Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit ka shkelur Kushtetutën, ka shkelur nenin III, pika 2, të ligjit nr.8834, datë 22.11.2001 për ratifikimin e “Konventës për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Europë”. Sipas Ministrisë, ajo ka nxjerrë urdhrin nr.350, datë 14.12.2020 “Për ngritjen e komisionit ad hoc, për kryerjen e procedurave mbi marrjen e vendimit për njohjen e gradave shkenore “Doktor” dhe “Titujve Akademikë” të fituar jashtë vendit.

Ministria e Arsimit më ka kthyer përgjigje ku thotë: Bazuar në procesverbalin nr.4, datë 17.12.2020, vendosi të mos e njoh titullin tuaj të fituar në Kolegjin Iliria Kosovë, duke patur dyshime se komisionin Ad Hoc e kanë keqpërdorur, sepse nuk dihet se çfarë i kanë paraqitur, si më kanë lakuar ose paragjykuar, nëse dosjen ia kanë paraqitur të plotë, të pjesshme, apo nuk ia kanë paraqitur fare.

I kam kërkuar dhe rikërkuar Ministrinë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ballafaqim bazuar në ligjet e Republikës së Shqipërisë, por kuadrot e ministrisë dhe të institucioneve në varësi të saj nuk i janë përgjigjur kërkesës time për ballafaqim. E drejta për t’u ballafaquar me faktet dhe provat me Ministrinë e Arsimit është e drejtë ligjore dhe Kushtetuese, por përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit shmangen nga ballafaqimi, shkelja e tyre e ligjit dhe kushtetutës, fshehja e të vërtetës, dhënia e vendimeve arbitrare, mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme, shkeljen e barazisë së shtetasve. Kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave më janë shkaktuar vuajtje të rënda nga persona që ushtrojnë funksione publike. Pastrimi i produkteve të veprave penale dhe të veprimtarisë kriminale të ushtruar ndaj meje. Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës. Moskallëzimi i krimit. Përkrahja e autorit të krimit. Mosmarrja e masave për zbardhjen e së vërtetës, investimi e mbulimin e krimit janë indikacion i diskriminimit, terrorit, torturës të ushtruar nga përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë, për motive të dobëta, ku nuk përjashtohet që kjo veprimtari kriminale të jetë me porosi të organizatave kriminalo-mafioze.

Veprimtaria e mohimit në bashkëpunim të drejtave të mia, trajtimi çnjerëzor që ka sjellë dëmtime të rënda të emrit tim, të personalitetit tim, të kontributit tim në shkencë dhe në shoqëri, janë forma të torturës, si pasojë e diskriminimit në seri.

Kam dy vite që i i drejtoj kërkesa Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit si dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, ku kam insistuar te zbatimi i ligjit dhe kam ftuar komisionin Ad Hoc, të përballlet me mua si nga ana profesionale, ashtu dhe nga ana intelektuale.”

Ankuesi deklaron se, së fundmi, vendimi me nr.6, datë 26.04.2024, i marrë nga Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademikë, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është një vendim antikushtetues, i cili shkel të drejtat e garantuara në Kushtetutë, pikërisht nenet 25, 18, 4/2, 5, 116 dhe 122 pika 2, si dhe nenin III, pika 2 të ligjit nr.8834, datë 22.11.2001, për ratifikimin “*Konventa për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Europë.*”

Ankuesi shprehet se, veprimet e Ministrisë së Arsimit dhe të institucioneve në varësi, janë në shkelje të hapur të parimeve të drejtësisë, të paanësisë, si dhe të dhunimit të Kushtetutës, janë kryer të organizuara dhe në bashkëpunim.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për shkak të bindjeve politike, gjendjes arsimore dhe çdo shkak tjetër, për shkak të mosnjohjes së titullit akademik “Profesor”, të fituar në Republikën e Kosovës.

Përfundimisht, ankuesi kërkon nga Komisioneri thirrjen e përfaqësuesve të institucioneve dhe ballafaqim, për të evidentuar arsyet e diskriminimit si dhe parashtrimin e çështjes në organet e specializuara, si SPAK etj.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar mbrojtje të drejtpërdrejtë nga diskriminimi për shkak të “*bindjeve politike*”, dhe “*gjendjes arsimore*” duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.866/2 prot, datë 20.06.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa, MAS, QSHA dhe UMT. Në përgjigje të kësaj kërkesë:

1.1 Me shkresën nr.2208/3 prot, datë 01.07.2024 (administruar pranë Komisionerit me nr. 866/4 prot datë 03.07.2024), ka kthyer përgjigje QSHA, e cila ndër të tjera parashtroi:

QSHA, është institucion publik, në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që ka për mision ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit të lartë dhe sigurimin e aksesit publik në të dhënat për arsimin e lartë. QSHA ushtron veprimtarinë në bazë të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1013, datë 10.12.2010 *“Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”*, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.8, datë 13.03.2017 *“Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”*, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore sipas fushave specifike të veprimtarisë.

QSHA-ja ka për objekt veprimtarie ofrimin e shërbimeve për qytetarët, IAL-të, institucionet e tjera dhe të tretët. Ofrimi i shërbimeve ndaj të tretëve bëhet nga QSHA-ja pas miratimit nga ministria përgjegjëse për arsimin, kundrejt pagesës së tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Organizimi, funksionimi i QSHA-së dhe procedurat e regjistrimit të studentëve rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

Midis kompetencave të QSHA në bazë të udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.21, datë 15.10.2021 *“Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njesimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”*, i ndryshuar, njeh dhe njëson diplomat e arsimit të lartë të fituara në institucione të huaja të arsimit të lartë, ose institucione të tjera të autorizuar, përveç gradave shkencore dhe titujve akademikë. Për këto të fundit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit është ngritur Komisioni i Njohjes së Gradave Shkencore dhe Komisioni *Ad Hoc* për Njohjen e Titujve Akademikë.

Në bazë të pikës 7.1, të kreut III, të udhëzimit të MAS nr.21, datë 15.10.2021, i ndryshuar, QSHA shërben si sekretariat teknik për Komisionin *Ad Hoc* për njohjen e titujve akademikë.

Z.S.H ka aplikuar në portalin *e-Albania* në datën 07.07.2023, për të njohur dhe njësuar titullin akademik “Profesor”, të fituar në Republikën e Kosovës. Aplikimi i tij ka marrë numrin e referencës: MASR-2023-5425812-ZL. Në vijim z.H ka dërguar me postë dokumentacionin shkresor. Në bazë të

pikës 7.1, të kreut III të udhëzimit të MAS nr.21, datë 15.10.2021, i ndryshuar, QSHA ka përcjellë pranë MAS aplikimin (riaplikimin) e z.H.

Komisioni *Ad Hoc* për Njohjen e Titujve Akademikë ka shqyrtuar ri-aplikimin e z.H dhe me vendimin nr.6, datë 26.04.2024, ka disponuar për këtë riaplikim. Z.H është njoftuar në datën 29.04.2024, nëpërmjet portalit *e-Albania* për tu paraqitur në QSHA për të tërhequr vendimin. Z. H nuk është paraqitur në QSHA për të tërhequr vendimin dhe në datë 15.05.2024, i është drejtuar QSHA për të kërkuar informacion në lidhje me aplikimin e tij. Kërkesa e tij është administruar në QSHA me nr.2208 prot, datë 16.05.2024. Me shkresën nr.2208/1 prot, datë 21.05.2024, QSHA, i ka kthyer përgjigje z.H, duke i bashkëngjitur edhe vendimin nr.6, datë 26.04.2024 të Komisionit *Ad Hoc* për njohjen e Titujve Akademikë. Deri në këtë moment, QSHA nuk është njoftuar për ndonjë proces gjyqësor të iniciuar nga z.H që kundërshton vendimet që kanë disponuar për mosnjohjen e titullit të tij. QSHA ka ushtruar dhe ka përfunduar në mënyrë rigoroze kompetencat e përcaktuara në udhëzimin e sipërcituar.

1.2 Me shkresën nr.310/5 prot, datë 03.07.2024 (administruar pranë Komisionerit me nr. 866/5 prot, datë 05.07.2024), ka kthyer përgjigje UMT, ku ndër të tjera parashtron:

Në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, sanksionohet se: *“Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj.”* UMT, si institucion publik i arsimit të lartë, i ushtron funksionet dhe kompetencat e tij në zbatim të ligjit nr.80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Gjithashtu UMT-ja e bazon veprimtarinë e saj akademike e administrative edhe në Statutin e UMT-së dhe aktet e tjera nënligjore të brendshme.

Në bazë të Statutit të UMT-së, kompetencën/të drejtën për të përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së personelit akademik me kohë të plotë e ka drejtuesi i departamentit në bazë të nevojave të njësisë bazë.

Lidhur me pretendimet për mungesë transparence nga UMT mbi kriteret dhe dosjet e aplikantëve, është informuar z. S.H se, referuar nenit 65, të Statutit të UMT, kriteret përcaktohen nga njësia kryesore dhe publikohen në njoftimin për vendin e lirë të punës dhe buletinin përkatës të Agjencisë së Prokurimit Publik.

UMT, me shkresat nr. 2574/2 prot., datë 28.10.2021 dhe nr.2574/5 prot datë 23.11.2021, nr.1405/2 prot., datë 08.05.2023 dhe nr.310 prot datë 12.02.2024, ka informuar edhe më herët z.S.H lidhur me procedurën e ndjekur për punësimin e personelit akademik, në lëndën “Mjekësi ligjore” në Fakultetin e Mjekësisë si dhe trajtimin e kërkesës së tij për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”.

Z. S.H ka depozituar dosjen për marrjen e titullit akademik në Fakultetin e Mjekësisë të UMT me datë 07.10.2015. Depozitimi i dosjes përkon me hyrjen në fuqi të ligjit nr.80/2015 dhe kohën e nevojshme për implementimin e tij në institucionet e arsimit të lartë. Sikurse e kemi sqaruar disa herë në korrespondenca shkresore me z.S.H , me ligjin nr.80/2015, është krijuar Komisioni Përhershëm Promovimit të Personelit Akademik, cili trajton dhe jep titujt akademikë “Profesor” dhe “Profesor Asociuar”, sipas përcaktimeve dhe akteve ligjore në fuqi. Afatet ligjore për trajtimin e

dosjes për fitimin e titujve akademikë në UMT përcaktohen në nenin 10 të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e KPPPA-së në UMT, afate që janë respektuar në mënyrë rigorozë dhe sipas kompetencave nga ky organ kolegjal, dhe mbi këtë procedurë z.S.H është njoftuar në çdo fazë dhe me transparencë.

1.3 Me shkresën nr.4029/1 prot, datë 05.07.2024 (administruar pranë Komisionerit me nr. 866/6 prot datë 08.07.2024), ka kthyer përgjigje MAS, ku ndër të tjera parashtron:

Z. S.H ka aplikuar në portalin *e-Albania* në datën 7.7.2023, për të njohur dhe njësuar titullin akademik “Profesor”, të lëshuar më datë 26.05.2017, nga Kolegji “Iliria”, Republika e Kosovës. Më pas ka dërguar me postë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dokumentacionin shkresor.

Me urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.179, datë 18.04.2024 “*Për ngritjen e Komisionit Ad Hoc për kryerjen e procedurave mbi marrjen e vendimit për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vëndit*”, është ngritur komisioni *Ad Hoc*, i cili sipas pikës 3 të këtij urdhri, kishte për detyrë të shqyrtonte dokumentacionin e aplikimeve për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vëndit si dhe të nënshkruante procesverbalet përkatëse në përfundim të procedurave të njohjes.

Sipas përmbajtjes së procesverbalit të mbajtur nga Komisioni *Ad Hoc*, i Njohjes së Titujve Akademik, në mbledhjen e datës 26.04.2024, rezulton se Sekretariati Teknik³, nëpërmjet *email*, i ka përcjellë komisionit informacionin dhe raportin teknik për aplikimet e depozituara për njohjen e titujve akademik të fituar jashtë vëndit në mënyrë që komisioni ti vlerësonte aplikimet në përputhje me përcaktimet e udhëzimit nr.21, datë 15.10.2021.

Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik në procesverbalin nr.3, protokolluar me nr.3857 prot datë 26.04.2024, për dosjen e depozituar nga z.S.H, është shprehur si vijon: “*III. Të mos rishqyrtojë dosjen e Titullit Akademik për S.N.H, Profesor Kolegji “Iliria”, Kosovë*”.

Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik, i ngritur me urdhrin nr.179, datë 18.04.2024, pasi ka verifikuar dokumentacionin e dosjes së z.H, i ka rezultuar se në vitin 2020, nga Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademikë, është marrë vendimi për mosnjohjen e titullit akademik “Profesor”, të fituar nga z.S.H, në Kolegjin Iliria”, Republika e Kosovës. Kjo vendimarrje është pasqyruar në procesverbalin nr.4, datë 17.12.2020. Gjithashtu, në aplikimin e ri të z.H nuk ka patur elementë shtesë që të mund të shërbenin si shtysë për rishqyrtim të dosjes së tij nga ky komision. Në përfundim Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik me vendimin nr.6, datë 26.04.2024, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit të komisionit të zbardhur në procesverbalin nr.4, datë 17.12.2020 “Mosnjohje e titullit akademik “Profesor”, lëshuar nga Kolegji “Iliria”, Republika e Kosovës për z.S.H.*”

Z. S.H ka aplikuar pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) në vitin 2020, për njohjen e titullit “Profesor”, në fushën e “Mjekësisë Ligjore” dhe “Penale”, të lëshuar nga Kolegji (Privat) Iliria, Kosovë. Aplikimi është regjistruar me nr.3149, datë 24.06.2020. Ky aplikim është shqyrtuar nga Komisioni *Ad Hoc*, i ngritur me urdhrin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me nr.350,

³ Bazuar në udhëzimin nr.21/2021, të ndryshuar, Kreu III, pika 7.1, Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA shërben si sekretariat teknik i komisioneve Ad Hoc.

datë 14.12.2020 *“Për ngritjen e komisionit Ad Hoc për kryerjen e procedurave mbi marrjen e vendimit për njohjen e gradave shkencore “Doktor” dhe titujve akademik të fituar jashtë vendit”*.

Sipas procesverbalit të Komisionit *Ad Hoc* me nr.4, datë 17.12.2020, për aplikimin e z.S.H është vendosur mosnjohja e titullit akademik me arsyetimin: *“Lidhur me aplikimet për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit, pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni Ad Hoc vendosi të mos njohë tituj akademikë për aplikantët si më poshtë: S.H, Profesor në fushën e “Mjekësisë Ligjore” dhe “Penale”, Kolegji (Privat), Iliria, Kosovë. Në bazë të përgjigjes së mëparshme të Enic-Naric (zyra e njohjes) në Kosovë, titujt e fituar në Universitetet private (si në rastin e z.H) nuk kanë vlerë kombëtare, por mund të transferohen vetëm brenda IAL-ve private, në bazë të vendimarrjes së universitetit pritës. Gjithashtu, në vitin 2018, Komisioni Ad Hoc ka vendosur mosnjohjen e një titulli të fituar në Kolegjin Iliria, Kosovë”*.

MASR me shkresën nr.3419/1 prot datë 24.12.2020, me lëndë *“Mbi aplikimin për njohjen e titullit akademik”*, ka njoftuar z.S.H për vendimarrjen e Komisionit *Ad Hoc*, për mosnjohjen e titullit akademik të fituar në Kolegjin “Iliria” Kosovë, sipas procesverbalit nr.4, datë 17.12.2020.

Në vijim të këtij njoftimi, z.H i ka drejtuar MASR ankesën e protokolluar me nr.3419/2 prot datë 30.12.2020, nëpërmjet së cilës ka kundërshtuar procesverbalin nr.4, datë 17.12.2020, të Komisionit *Ad Hoc*. MASR, me shkresën nr.73 prot datë 07.01.2021, me lëndë *“Lidhur me ankesën mbi vendimin e Komisionit Ad Hoc”*, drejtuar z.H, i ka bërë me dije arsyetimin e komisionit për mosnjohjen e titullit të tij akademik duke marrë në konsideratë dhe përgjigjen nga Enic-Naric (Zyra e njohjes) në Kosovë.

Z.S.H , e ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore vendimin e Komisionit *Ad Hoc* nr.4, datë 17.12.2020, nëpërmjet kërkesë padisë të depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.717, datë 16.03.2021, ka rrëzuar kërkesë padinë e paditësit z.H, për kundërshtimin e procesverbalit të Komisionit *Ad Hoc* me nr.4, datë 17.12.2020.

Procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të titujve akademik të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë janë përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.21, datë 15.10.2021 *“Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”*, i ndryshuar (referuar Udhëzimi nr.21/2021, i ndryshuar).

Nga dokumentacioni i administruar lidhur me riaplikimin e z.H për njohjen e titullit akademik “Profesor”, lëshuar nga Kolegji privat “Iliria”, Republika e Kosovës, rezulton se Komisioni *Ad Hoc*, i ngritur me urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.179, datë 18.04.2024, ka zbatuar procedurën e përcaktuar në udhëzimin e sipërcituar. Me procesverbalin nr.3, datë 26.04.2024, Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik, ka vendosur të mos rishqyrtojë dosjen e titullit akademik “Profesor”, për z. S.H.

Vendimi nr.6, datë 26.04.2024, i Komisionit *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik, është marrë në zbatim të procedurës së përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe është bazuar në: verifikimin e dokumentacionit të ridepozituar nga z.H; vendimarrjen e mëparshme të Komisionit *Ad Hoc*, sipas procesverbalit me nr.4, datë 17.12.2020; si dhe faktin që në aplikimin e ri të z.H nuk kishte element shtesë që mund të shërbenin si shtysë për rishqyrtimin e aplikimit të tij të ri.

Përfundimisht me vendimin nr.6, datë 26.04.2024, Komisionit *Ad Hoc* Njohjes së Titujve Akademik është plotësisht bazuar në legjislacionin për arsimin e lartë dhe për pasojë nuk ka shkelur asnjë të drejtë kushtetuese të ankuesit si dhe nuk ka krijuar situatë diskriminuese për asnjërin prej shkaqeve të pretenduara të tij.

2. Ankuesi depozitoi prapësimet e tij në lidhje me parashtrimet e depozituara nga MAS, UMT dhe QSHA, të cilat u administruan pranë Komisionerit me nr.866/8 prot datë 17.07.2024, duke pretenduar si të pabazuara qëndrimet dhe parashtrimet e depozituara nga ana e këtyre institucioneve.
3. Me shkresën nr.866/3 prot, datë 20.06.2024, Komisioneri iu drejtua me një kërkesë për informacion ankuesit, nëpërmjet të cilës i kërkoi këtij të fundit shpjegime në lidhje shkaqet e pretenduara të diskriminimit bindjet politike, gjendja arsimore dhe çdo shkak tjetër. Në përgjigje të kësaj kërkesë, ankuesi depozitoi parashtrimet e tij, të cilat u administruar pranë Komisionerit me nr. 866/3 prot datë 01.07.2024, ku ndër të tjera parashtron:

Në lidhje me shkakun e bindjeve politike, ankuesi shpjegon se familja e tij ka qenë nismëtare, themeluese e Partisë Demokratike Qarku Dibër dhe babai i tij (N.H) ka mbajtur pozicionin e nënkryetarit të parë të Partisë Demokratike Qarku Dibër. Më tej ankuesi deklaroi se, ai ka qenë anëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë që në themelim, kandidat për kryetar të Partisë Demokratike të Shqipërisë në vitin 2021. Në një vend ku lufta politike është e ashpër, për shkak të bindjeve të tij politike, atij i është mohuar e drejta për tu zgjedhur drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore, pozicion në të cilin u emëruar një person pa nivelin profesional dhe akademik, i është vjedhur pozicioni i punës si pedagog në Universitetin e Mjekësisë, nuk i është dhënë titulli i merituar “Profesor” nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë, si dhe nuk i është njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit titulli akademik i fituar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë.

Në lidhje me shkakun e gjendjes arsimore, ndër të tjera ankuesi parashtron se deri në shkurt të vitit 2014, ka qenë ekspert me gradën shkencore në Institutin e Mjekësisë Ligjore Tiranë, gjithashtu ka qenë ekspert me arritjet brilante në profesionin e tij, ku asnjë akt ekspertimi mjeko-ligjor të cilin ai e ka përpiluar, nuk ka patur ecure negative. Pasi paraqiti në vitin 2013 kërkesën për të konkuruar në pozicionin e Drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, ndaj tij filloi një armiqësi dhe nuk u lejua të konkuronte si person profesionist, ekspert me gradën shkencore (i vetmi) brenda në institucion, por me vendim partiak-mafioz e larguan nga puna edhe si ekspert.

Gjithashtu, dosjet e paraqitura në konkursin e kryer për pozicionin e pedagogut të brendshëm në vitin 2015, pavarësisht insistimit të ankuesit, nuk u bë transparencë nga Universiteti i Mjekësisë dhe se ankesa e tij, përfshi edhe diskriminimin, në Ministrinë e Arsimit në lidhje me konkursin, nuk mori

asnjëherë përgjigje. Ankuesi parashtron se, niveli arsimor që zotëron dhe përgatitja e tij profesionale ua verbon sytë kriminelëve me pushtet, për arsyen e qartë se krimi i organizuar nuk do oponencë.

Ankuesi pretendon se diskriminimi ndaj tij është kryer edhe për arsye se ai i përket pakicave kombëtare, pasi ka lindur në Trebisht-Dibër. Veprimet diskriminuese ndaj tij janë të kordinuara dhe të organizuara dhe kanë sjellë pasoja shumë të rënda ekonomike, duke i cenuar të drejtën për të jetuar një jetë të denjë, duke i privuar barazinë, duke i cenuar integritetin.

Mbas aplikimit për të kandiduar në pozicionin e drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore në vitin 2013, diskriminimi, përndjekja, poshtërimi, tortura kanë qenë dhe janë në çdo hap të jetës së tij.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, S.H , ka aplikuar në portalin *e-albania* në datën 07.07.2023, për të njohur dhe njësuar titullin akademik “Profesor”, të lëshuar më datë 26.05.2017, nga Kolegji “Iliria”, të fituar në Republikën e Kosovë. Nga aktet e administruara konstatohet se, ankuesi ka aplikuar për hapjen e dosjes në lidhje me kërkesën e tij për njohjen e titullit akademik të fituar jashtë vendit, më herët se data 07.07.2023, por nga korrespondenca që ai ka patur me QSHA dhe MAS, rezulton se aplikimi i tij është vlerësuar në përputhje me rregullat në fuqi në datën 07.07.2023, pasi ai ka bërë aplikimin në platformën *e-albania*.

Aplikimi i ankuesit për të njohur dhe njësuar titullin akademik “Profesor”, të lëshuar më datë 26.05.2017, nga Kolegji “Iliria”, të fituar në Republikën e Kosovë, është marrë në shqyrtim nga Komisioni Ad Hoc i Njohjes së Titujve Akademikë, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, i cili me vendimin nr.6, datë 26.04.2024, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit të komisionit të zbardhur në procesverbalin nr.4, datë 17.12.2020 “Mosnjohje e titullit akademik “Profesor”, lëshuar nga Kolegji “Iliria”, Republika e Kosovës, për z.S. N.H ”.*

Ankuesi ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, gjendjes arsimore dhe çdo shkak tjetër,

Ligji nr.80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, në nenin 92 *“Njohja e diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë”*, përcakton:

“1. Diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, njihen dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar

arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.

2. Një kualifikim apo program studimi i kryer jashtë vendit, për të cilin është lëshuar një certifikatë, diplomë apo gradë nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, që vërteton përfundimin e kualifikimit apo programit të studimit, vlerësohet, njihet dhe njësohet në bazë të Kornizës Europiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës së Kualifikimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë.

3. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar, në Republikën e Shqipërisë, të certifikatave, diplomave dhe gradave shkencore është ministria përgjegjëse për arsimin. Ky proces kryhet nga njësia përgjegjëse e njësimit të diplomave.

4. Titujt e lëshuar jashtë vendit nga një institucion i huaj i arsimit të lartë njihen në Republikën e Shqipërisë, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, përmes procedurës zyrtare të njohjes.

5. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare, në Republikën e Shqipërisë, të titujve akademikë të lëshuar jashtë vendit është ministria përgjegjëse për arsimin.

6. Procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe njohjen e titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim. Ministria përgjegjëse për arsimin mund të përcaktojë dhe vlefshmërinë e diplomës së njësuar, sipas fushës së punësimit.

7. Ministria përgjegjëse për arsimin mban bazën e të dhënave kombëtare të diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të njësuar apo të njohur në Republikën e Shqipërisë.”

Procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë të titujve akademik të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, përcaktohen në udhëzimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.21, datë 15.10.2021 “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara”, i ndryshuar (në vijim udhëzimi nr.21/2021, i ndryshuar), i cili përcakton se, kjo procedurë kryhet online nëpërmjet portalit *e-Albania*. Në Kreun III “Procedurat e njohjes dhe njësimit”, pika 7, të këtij udhëzimi, përcaktohet:

“7. Për njohjen e titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin komisione ad hoc, për secilin aplikim për njohje titulli akademik të fituar jashtë vendit, me pedagogë ekspertë

të fushës përkatëse të kategorisë “Profesor”. Komisionet ad-hoc për njohjen e titujve akademikë kryesohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe përbëhen nga kryetari dhe katër anëtarë.

7.1 Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA shërben si sekretariat teknik i komisioneve ad hoc.

7.2 Kërkesa për ngritjen e komisionit ad hoc kryhet nga Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA, menjëherë pas depozitimit të aplikimit për njohjen e titullit akademik të fituar jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.

7.3 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit ad hoc nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin përkatës. Nëse është vendosur njohja e titullit akademik, vërtetimi lëshohet nëpërmjet sistemit online me nënshkrim dhe vulë elektronike të kryetarit, sipas shtojcës nr.5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

7.4 Procedura e njohjes së titullit akademik të fituar jashtë vendit, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.

7.5 Përcaktimet e pikave 1.2 dhe 1.3 të kreut III të këtij udhëzimit, lidhur me afatet procedurale, aplikohen edhe për aplikimet për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore të fituara jashtë vendit.”

Sa më sipër rezulton se njohja dhe njësimi i titujve akademikë të fituar jashtë vendit kryhet nga një komision Ad Hoc, i cili ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, për secilin aplikim për njohje titulli akademik të fituar jashtë vendit, me pedagogë ekspertë të fushës përkatëse të kategorisë “Profesor”, ndërsa Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA shërben si sekretariat teknik i komisioneve ad hoc.

Bazuar në aktet e administruara rezulton se, me urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.179, datë 18.04.2024 “Për ngritjen e Komisionit Ad Hoc për kryerjen e procedurave mbi marrjen e vendimit për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit”, është ngritur komisioni Ad Hoc, i cili sipas pikës 3 të këtij urdhri, kishte për detyrë të shqyrtonte dokumentacionin e aplikimeve për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit si dhe të nënshkruante procesverbalet përkatëse në përfundim të procedurave të njohjes.

Në lidhje me aplikimin e ankuesit, rezulton se me shkresën nr.3713 prot, datë 08.09.2023, QSHA i është drejtuar MAS, si vijon: “Në Qendrën e Shërbimeve Arsimore është depozituar aplikimi i z.S.H, për njohjen dhe njësimin e titullit akademik “Professor”, të fituar në Kolegjin Universitar “Iliria”, Republika e Kosovës. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, si dhe referuar shkresës Suaj nr.2012/2 prot, datë 30.03.2024, rezulton se për z.H, Komisioni i Njohjes së Titujve Akademikë ka marrë një herë vendimin përkatës dhe ka zbardhur procesverbalin nr.4, datë 17.02.2020 me anë të të cilit është vendosur të mos njihet titulli akademik “Profesor”, i fituar në Kolegjin Universitar “Iliria”, Republika e Kosovës. Përsa më sipër, duke qenë se kemi të bëjmë me një aplikim të përsëritur për të njëjtin titull akademik, në mënyrë që Komisioni Ad Hoc që do të ngrihet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të marri një vendim shterues për rastin në fjalë, kërkojmë nga Ju të na vendosni në dispozicion një kopje të dosjes me vulë të njomë që kjo dosje ti paraqitet Komisionit për të marrë vendimin përkatës”.

Nuk rezulton nga aktet e administruara se, kur QSHA ka përcjellë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit aplikimin e ankuesit. Megjithatë rezulton se, Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik, i ngritur me urdhrin nr.179, datë 18.04.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, nuk rezulton të jetë ngritur për një aplikim të veçantë apo vetëm për aplikimin e ankuesit, por për kryerjen e procedurave në marrjen e vendimit mbi njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit për aplikimet e paraqitura. Kështu, rezulton se Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik, i ngritur me urdhrin nr.179, datë 18.04.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit ka marrë në shqyrtim jo vetëm aplikimin e ankuesit, por edhe 6 (gjashtë) aplikime të tjera, për të cilat në 3 (tre) raste ka vendosur të njohë titujt akademik të aplikantëve dhe në 3 (tre) raste ka vendosur të mos njohë titujt akademik të aplikantëve.

Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik, i ngritur me urdhrin nr.179, datë 18.04.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, ka shqyrtuar aplikimet e paraqitura për njohjen dhe njësimin e titujve akademikë të fituar jashtë vendit në mbledhjen e tij të datës 26.04.2024, ku është mbajtur procesverbali përkatës me të njëjtën datë me nr.3857 prot, datë 26.04.2024. Sipas përmbajtjes së procesverbalit, rezulton se, pas paraqitjes së informacioneve dhe raportit teknik për aplikimet e depozituara për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit nga ana e Sekretariatit Teknik/Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA, Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik, është shprehur: *“III. Të mos rishqyrtojë dosjen e Titullit Akademik si më poshtë: 1. S.N, H, Profesor, Kolegji “Iliria”.*

Në përfundim Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik me vendimin nr.6, datë 26.04.2024, ka vendosur: *“Lëniën në fuqi të vendimit të komisionit të zbardhur në procesverbalin nr.4, datë 17.12.2020 “Mosnjohje e titullit akademik “Profesor”, lëshuar nga Kolegji “Iliria”, Republika e Kosovës për z.S.H.”.* Në këtë vendim, Komisioni *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik, arsyeton se: *“.... Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se, për z.H, Komisioni Ad Hoc i Njohjes së Titujve Akademikë ka marrë një herë vendim bazuar në procesverbalin nr. 4, datë 17.12.2020, me anë të të cilit është vendosur të mos njihet titulli akademik “Profesor”, i fituar në Kolegjin “Iliria”, Republika e Kosovës.....nëpërmjet shqyrtimit në komision, të mbajtur me procesverbalin nr.4, datë 17.12.2020, kjo dosje është trajtuar nga Komisioni Ad Hoc dhe ka marrë përgjigje shteruese. Gjithashtu, në aplikimin e ri të zotit H nuk ka elementë shtesë që mund të shërbenin si shtysë për rishqyrtimin të dosjes së tij të aplikimit.”*

Rezulton e provuar se, ankuesi ka aplikuar pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) në vitin 2020, për njohjen e titullit “Profesor”, të lëshuar nga Kolegji “Iliria”, Kosovë. Ky aplikim është shqyrtuar nga Komisioni *Ad Hoc*, i ngritur me urdhrin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me nr.350, datë 14.12.2020 *“Për ngritjen e komisionit Ad Hoc për kryerjen e procedurave mbi marrjen e vendimit për njohjen e gradave shkencore “Doktor” dhe titujve akademik të fituar jashtë vendit”.*

Sipas procesverbalit të Komisionit *Ad Hoc* me nr.4, datë 17.12.2020, për aplikimin e z.S.H është vendosur mosnjohja e titullit akademik me arsyetimin: *“Lidhur me aplikimet për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit, pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni Ad Hoc vendosi*

të mos njohë tituj akademikë për aplikantët si më poshtë: S.H, Profesor në fushën e “Mjekësisë Ligjore” dhe “Penale”, Kolegji (Privat), Iliria, Kosovë. Në bazë të përgjigjes së mëparshme të Enic-Naric (zyra e njohjes) në Kosovë, titujt e fituar në Universitetet private (si në rastin e z.H) nuk kanë vlerë kombëtare, por mund të transferohen vetëm brenda IAL-ve private, në bazë të vendimarrjes së universitetit pritës. Gjithashtu, në vitin 2018, Komisioni Ad Hoc ka vendosur mosnjohjen e një titulli të fituar në Kolegjin Iliria, Kosovë”.

MASR me shkresën nr.3419/1 prot, datë 24.12.2020, me lëndë “*Mbi aplikimin për njohjen e titullit akademik*”, ka njoftuar ankuesin për vendimarrjen e Komisionit Ad Hoc, për mosnjohjen e titullit akademik të fituar në Kolegjin “Iliria” Kosovë, sipas procesverbalit nr.4, datë 17.12.2020.

Në vijim të këtij njoftimi, z.H i ka drejtuar MASR ankesën me nr.3419/2 prot, datë 30.12.2020, nëpërmjet së cilës ka kundërshtuar procesverbalin nr.4, datë 17.12.2020, të Komisionit Ad Hoc. MASR, me shkresën nr.73 prot datë 07.01.2021, me lëndë “*Lidhur me ankesën mbi vendimin e Komisionit Ad Hoc*”, drejtuar z.H, i ka bërë me dije arsyetimin e komisionit për mosnjohjen e titullit të tij akademik.

Rezulton se, ankuesi e ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore vendimin e Komisionit Ad Hoc nr.4, datë 17.12.2020, nëpërmjet kërkesë padisë të depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.717, datë 16.03.2021, ka rrëzuar kërkesë padinë e paditësit z.H, për kundërshtimin e procesverbalit të Komisionit Ad Hoc me nr.4, datë 17.12.2020, vendim gjyqësor i cili deri në këto momente nuk rezulton të ketë marrë formë të prerë.

Referuar vendimit gjyqësor nr.717, datë 16.03.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se përveç revokimit dhe shfuqizimit të vendimit nr.4, datë 17.12.2020 të Komisionit AdHoc për mosnjohjen e titullit akademik “*Profesor*”, të lëshuar nga Kolegji “Iliria”, Republika e Kosovës, ankuesi ka ngritur para gjykatës edhe pretendime për konstatimin e diskriminimit dhe shpërblimin e dëmit si pasojë e diskriminimit të pësuar. Ndër të tjera, në këtë vendim, Gjykata arsyeton: “*Në lidhje me pretendimin e palës paditëse për konstatimin e diskriminimit dhe shpërblimin e dëmit në lidhje me diskriminimin gjatë veprimtarisë së Komisionit Ad Hoc të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, gjykata çmon se ky pretendim është i pabazuar. Nga ana e palës paditëse nuk u provua gjatë gjykimit asnjë veprim konkret i të paditurit që mund të ketë çuar në trajtim jo të barabartë për shkak të elementëve të veçantë si, bindjet politike, etnia të pretenduara nga pala paditëse.*” Gjykata në përfundim të shqyrtimit të kërkesë padisë së ankuesit, ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesë padisë së paditësit S.H si të pabazuar në ligj dhe në prova.*”

Ankuesi është njoftuar për përfundimin e procedurës për njohjen e titullit akademik në datën 29.04.2024 nëpërmjet portalit e-Albania dhe për t’u paraqitur në QSHA për të tërhequr vendimin. Nuk rezulton që ankuesi të jetë paraqitur në QSHA sipas këtij njoftimi për të tërhequr kopjen e vendimit. Në datën 15.05.2024 ankuesi i është drejtuar QSHA për të kërkuar informacion në lidhje me aplikimin e tij. Me shkresën nr.2208/1 prot, datë 21.05.2024, QSHA i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke i vendosur në dispozicion edhe vendimin nr.6, datë 26.04.2024 të Komisionit Ad Hoc.

Në kushtet kur, në lidhje me aplikimin e ankuesit për njohjen dhe njësimin e titullit akademik “Profesor” të lëshuar nga Kolegji Iliria, Republika e Kosovës, ka patur një vendimarrje të mëparshme të Komisionit *Ad Hoc*, sipas procesverbalit me nr.4, datë 17.12.2020, vendimarrje e cila nuk rezulton të jetë shfuqizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ankuesi ka riaplikuar për njohjen dhe njësimin e të njëjtit titull akademik dhe në aplikimin e ri nuk rezulton të jenë paraqitur elemente shtesë që mund të shërbenin për rishqyrtimin e aplikimit të ri, Komisioneri vlerëson se, vendimi nr.6, datë 26.04.2024, i Komisionit *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademikë, i ngritur me urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.179, datë 18.04.2024, nuk e ka ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm.

Bazuar në gjithë sa më sipër, ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e MAS dhe QSHA, në lidhje me procedurën e ndjekur për njohjen dhe njësimin e titullit akademik “Profesor” të lëshuar nga Kolegji Iliria, Republika e Kosovës, e cila është finalizuar me vendimin nr.6, datë 26.04.2024, i Komisionit *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademik, i ngritur me urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.179, datë 18.04.2024. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Për sa i përket vendimarrjes së Komisionit *Ad Hoc*, për mosnjohjen e titullit akademik të fituar në Kolegjin “Iliria” Kosovë, sipas procesverbalit nr.4, datë 17.12.2020, kjo vendimarrje nuk mund të merret në shqyrtim nga Komisioneri për dy arsye:

Së pari, kjo vendimarrje është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, ku ankuesi ka ngritur edhe pretendime për diskriminim për shkak të bindjeve politike dhe etnisë, dhe për rrjedhojë në bazë të nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile ku përcaktohet se: “*Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata*” dhe nenit 33, pika 7/4, të LMD, ku përcaktohet se: “*7/4. Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.*”, Komisioneri nuk ka kompetencë për të shqyrtuar pretendimet e paraqitura nga ankuesi në lidhje me vendimarrjen e Komisionit *Ad Hoc*, për mosnjohjen e titullit akademik të fituar në Kolegjin “Iliria” Kosovë, sipas procesverbalit nr.4, datë 17.12.2020.

Së dyti, edhe në kushtet kur ankuesi nuk do të kishte kundërshtuar gjyqësisht vendimarrjen e Komisionit *Ad Hoc*, për mosnjohjen e titullit akademik “Profesor” të fituar në Kolegjin “Iliria” Kosovë, sipas procesverbalit nr.4, datë 17.12.2020, në referim të nenit 33, pika 4, të LMD, ku përcaktohet se: “*4. Ankesa nuk pranohet nëse:dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese.*”, ankesa në lidhje me vendimarrjen e Komisionit *Ad Hoc*, për mosnjohjen e titullit akademik të fituar në Kolegjin “Iliria” Kosovë, sipas procesverbalit nr.4, datë 17.12.2020, nuk mund të pranohet për shqyrtim nga Komisioneri, pasi është paraqitur jashtë afateve ligjore.

Në lidhje me pretendimet që ankuesi ka paraqitur kundrejt UMT, të cilat lidhen me procedurën për marrjen e titullit akademik “Profesor” në Fakultetin e Mjekësisë në UMT dhe procedurën për rekrutimin si personel akademik në lëndën “Mjekësi Ligjore”, në Fakultetin e Mjekësisë në UMT, në bazë parashtrimeve të ankuesit, por edhe akteve të administruara, konstatohet se janë procedura të cilat janë zhvilluar në vitin 2015.

Gjithashtu, konstatohet se, referuar vendimit nr. 717, datë 16.03.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, proces gjyqësor në të cilin UMT ka qenë palë si person i interesuar, konstatohet se, ankuesi ka ngritur pretendime edhe në lidhje me këto dy procedura dhe konkretisht në vendimin gjyqësor citohet: *“Gjatë hetimit gjyqësor të çështjes dhe në kuadër të pretendimeve përfundimtare paditësi parashtroi këto pretendime:Në vitin 2015 kam konkuruar për pozicionin e pedagogut të brendshëm në Universitetin e Mjekësisë i bindur në fitore absolute ma kanë vjedhur vendin e punës si pedagog ndërkaq i jam drejtuar rektorit Arben Gjata me datë 08.01.2016 për t’u ballafaquar si dhe u jam ridrejtuar përsëri më datë 03.02.2016 si rektorit të Universitetit të Mjekësisë ashtu edhe Ministrisë së Arsimit që ligjëroi me heshtjen e saj vjedhjen e vendit të punës shkeli ligjin nr.80/2015 neni 2 pika c dhe ç. Po në vitin 2015 kam aplikuar për titullin akademik profesor aplikim që kryhet pasi plotëson të gjitha kriteret, por akoma pas shtatë vitesh nuk më është akorduar, përse kjo zvarritje nëse nuk është diskriminim çfarë është?”*

Bazuar në sa më sipër si dhe në referim të nenit 33, pika 4, germa “dh”, të LMD, pretendimet për diskriminim të ankuesit në lidhje me këto dy momente janë jashtë afateve ligjore dhe rrjedhimisht Komisioneri, nuk mund ti marrë ato në shqyrtim dhe njëkohësisht në bazë të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 33, pika 7/4, të LMD, komisioneri nuk mund të pranojë për shqyrtim pretendimet për diskriminim që janë paraqitur para organeve gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit S.H , nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore, në lidhje me procedurën e ndjekur për njohjen dhe njësimin e titullit akademik “Profesor” të lëshuar nga Kolegji Iliria, Republika e Kosovës, në datën 26.05.2017, e cila është finalizuar me vendimin nr.6, datë 26.04.2024, i Komisionit *Ad Hoc* i Njohjes së Titujve Akademikë, i ngritur me urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.179, datë 18.04.2024, për shkaqet e pretenduara të diskriminimit.
2. Mospranimin e ankesës në lidhje me pretendimet e tjera për diskriminim të paraqitura në ankesë si dhe pretendimet e paraqitura kundrejt Universitetit të Mjekësisë Tiranë, pasi nuk përmbushin

kriteret ligjore të parashikuara nga ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi“, të ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Bindje politike, gjendje arsimore, çdo shkak tjetër
Fusha: Arsim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim/Mospranim